

mbajt diskutimi me temën "Çfarë mund të jetë e ardhmja e Prishtinës"

# Ka filluar realizimi i «Planit Strategjikë Zhvillimor i Prishtinës»

Plani Strategjik Zhvillimor do të implementohet si tërësi, përdoren planet janë vënë në jetë. Ju siguroj që këto plane nuk janë "utopi", tha kryetari Beqiri

ton ADEMI

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) dhe European Stability Initiative, ka mbajtur diskutim me temën "Çfarë mund të jetë e ardhmja e Prishtinës? Qeverisja dhe planifikimi në kryeqytetin e Kosovës. Në këtë diskutim kanë marrë pjesë kryetari i Kuvendit Komunal të Prishtinës, Ismet Beqiri, Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Ardian Gjini dhe disa qytetarë.

Temë diskutuese në këtë takim nga iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) ishte "Plani Strategjikë Zhvillimor i Prishtinës", të cilën strategji "IKS" e ka quajtur "utopi".

Verena Knaus, analiste nga European Stability Initiative, theksoi se "Plani strategjik 2020 është i ngjashëm me realitetin e Prishtinës. Ajo gjithashtu tha se realizimi i kësaj strategjie vështirë se do mund të implementohet. "Në këtë plan përdoren supozime të pa baza. Po ashtu në këtë strategji thuhet se nuk të dhëna të qëndrueshme për popullsinë e Kosovës", bëri të ditur a. Knaus.

Ndërsa, Drita Shahini, drejtoreshë e zekutive e Iniciativës Kosovare për Stabilitet, theksoi se sipas plan-zhvillimi i vazhdueshëm urban të zgjeroi qytetin nga 2.200 hektarë sa ka sot në vitin 2020 do të rritë në 10.000 hektarë. Ajo gjithashtu theksoi se toka industriale që shtrihen sot në 120-130 hektar, planifikohet të rritet në 60 hektar. "Ky plan propozon rritimin e një numri të madh të ndërtesave ekzistuese. Niveli privatë në lagjen Kalabria qytetit, vendbanimet e vjetra në lagjen Tophane së bashku me xhaminë e Llapit, si dhe zonën komerciale të Hajvali. Në këto pjesë janë bërë investime të mëdha private për të guruar infrastrukturën themelore", bëri në pah znj. Shahini.

Gjithashtu, Iniciativa Kosovare për Stabilitet, rekomandon drejtorit të KK-së që të bashkëpunojnë mes veti. Po ashtu dhe institucioneve komunale dhe atyre qendrore, si dhe organizatave që ende varen nga KKM-ja. Kjo organizatë ka konstat-



uar se deri më tash ka munguar një bashkëpunim i tillë. Në fund aktivitetet e "IKS"-së, pyetën kryetarin Beqiri se edhe sa kohë i duhet Prishtinës që të bëhet një qytet sikurse Lubjana?

Ndërkaq, në anën tjetër Kryetari i KK të Prishtinës, Ismet Beqiri, theksoi se "më vjen mirë që më në fund dikush u organizoi këso diskutimesh lidhur me sfidat, problemet dhe për të arriturat e kryeqytetit". Beqiri duke ju përgjigjur pyetjes së aktivistëve të "IKS"-së theksoi se "Prishtina nuk mund të bëhet Lubjanë për një kohë të shkurtër. E para e punës është që të bëhemi shtet". Beqiri, më tej foli për sfidat me të cilat është duke u përballur kryeqendra.

Ai tha se Prishtina ka një gjendje të trashëguar katastrofike në aspektin e planifikimit, ngase shumë lagje të Prishtinës kanë qenë të pa urbanizuara. "Mungesa e një planifikimi të mëhershëm ka sjellë probleme të cilat edhe i kemi aktualisht". Ai gjithashtu përmendi edhe disa probleme me të cilat ballafaqohet KK i Prishtinës. "Mungesa e infrastrukturës ligjore, pushteti disa shkallësh, ku ende nuk kemi kompetenca të ndara. Cilat kompetenca i takojnë pushteti qendror, cilat atij lokal dhe cilat përgjegjësi i ka supermenaxhmenti i AKM-së". Be-

qiri, bëri të ditur se KK ka bërë me dhjetëra fletëparaqitje në gjykata për shkelësit e ligjit për të cilat gjykata ende nuk ka kthyer përgjigjeje. Ai gjithashtu, theksoi se për realizimin e projekteve afatgjate dhe afatshkurtra pengesë është edhe mos zgjidhja e statusit të Kosovës. Për shkak të kësaj mundimi të marrin kredi nga vendet e jashtme. Ai gjithashtu theksoi se KK i Prishtinës ka buxhetin më të vogël në krahasim me vendet e rajonit.

"Nëse krahasojmë buxhetin e Tiranës që i ka 85 milion dollarë. Ata kanë mekanizmin ekzekutiv të cilin ne nuk e kemi, si policinë ndërtimore, tatimore atë komunale, etj". Beqiri, shtoi se Prishtina vetëm me emër është kryeqendër, ngase kjo nuk është e rregulluar as juridikisht dhe as financiarisht. Numri një i Prishtinës, foli edhe për planet që i ka hartuar KK i Prishtinës.

"Në vitin 2004 kemi hartuar vizionin për Prishtinën të cilin nuk e ka pasur. Gjithashtu kemi hartuar planet rregullative për tri unaza, si dhe projektin për trenin urban". Ai më tej bëri të ditur se "pas hartimit të këtyre planeve, ka filluar edhe realizimi i disa prej tyre". Beqiri, u shpreh i sigurt se kjo strategji do të implementohet. Kjo nuk është "utopi" përdërisa këto plane janë vënë në jetë. Askush nuk do të na

ndihmon nëse nuk kemi plane. Ju siguroj që këto plane nuk janë utopi", u tha të pranishmëve ai.

Ardian Gjini, Ministër i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, theksoi se "Prishtina përveç probleme të tjera ajo problem ka edhe rritjen e popullsisë që ka pasur".

Z. Gjini, theksoi se disa probleme me të cilat ballafaqohen qytetarët, çdo ditë kërkojë zgjidhje më të shpejta. "Përveç departamentit të Urbanizimit dhe të Planifikimit,

të ketë një ndarje në mes njesive të planifikimit afatgjatë dhe atyre të menaxhimit urban, në mënyrë që të ketë zgjidhje më të shpejta për probleme të cilat ballafaqohen qytetarët çdo ditë, si problemi i komunikacionit etj", theksoi z. Gjini.

Në anën tjetër, Lulzim Nixha, drejtor i Drejtorisë për Urbanizim, theksoi se strategjia për Prishtinën është punuar për një kohë të shkurtër. "Në grupin që ka punuar në planifikimin e qytetit ka qenë dhe njëri prej institutëve gjermane. Ata kanë përvuajtë të madhe sidomos në Evropën juglindore, në planifikime të tilla", bëri të ditur ai. Z. Nixha, tha se të gjithë ekspertët vendorë që janë marrë me këso punë kanë qenë të inkuadruar në hartimin e kësaj strategjie. Ai tha se ky planifikim është shumë real dhe të ardhmen do të realizohet.